



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:237944

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05586642

CPK.nr.21/24
P.nr.346/21

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm-Divisioni civil, përmes gjyqtarit G.A, në procedurën përmbarimore, sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, "O.P", SH.P.K, me seli në fsh. K. K. Gjilan, ndaj debitorit Sh. O., rr. "F.I", Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 12.10.2021, të ushtruar ndaj Urdhërit Përmbarimor P.nr.346/21, i dt. 07.10.2021, të Përmbaruesit Privat, jashtë seancës gjyqësore, më datën 17.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i datës 12.10.2021, të debitorit, Sh. O nga Gjilani, të paraqitur kundër Urdhërit Përmbarimor P.nr.346/21, i dt. 07.10.2021, të Përmbaruesit K. M nga Gj.

II.Mbetet në fuqi Urdhërit Përmbarimor P.nr.346/21, i dt. 07.10.2021, të Përmbaruesit Privat.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, K, me Urdhërin Përmbarimor, P.nr.346/21, i dt. 07.10.2021 ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori "O. P", me seli në fsh. K, K. Gj. lidhur me përmbushjen e obligimeve, që brenda afatit prej shtatë ditë nga data e dorëzimit të urdhërit, ti a pagunte kreditorit shumën në lartësi prej 5000.00€, me kamatë prej 8% nga dita kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive. Në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës me numër 01/07/078/2021, të datës 07.08.2021.

Debitori brenda afatit ligjor, pas pranimit të Urdhërit për Përmbarim më datën 12.10.2021, ka ushtruar prapësim, duke theksuar se vendimi përmbarimor është në kundërshtim me dispozitën ligjore – nenin 71 të LPP-së, pasi që fatura me numër 01/07/078/2021, e datës 07.08.2021, nuk përbën bazë juridike për përmbarim, përshkak se nuk është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, dhe sipas kësaj dispozite ligjore në mënyrë kumulative kërkohet që dokumenti i besueshëm të jetë i përshtatshëm për përmbarim, nëse tregohet debitori andaj edhe mungesa e njërit prej elementeve e bënë dokumentin të pa përshtatshëm. Mospranimi i kësaj fature vërtetohet sipas dokumentit të postës – fletëkthimin e datës 22.09.2021, dhe libri i

dorëzimit i datës 20.09.2021, ku debitori e ka siguruar tek Posta dega në Gjilan, andaj edhe duke analizuar këto dy dokumente konstatohet se nënshkrimi i paraqitur në emër të debitorit është falsifikuar. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhëri Përmbartimor P.nr. 346/21, i datës 07.10.2021.

Kreditori brenda afatit ligjor me datën 19.10.2021, ka ushtruar përgjegje në prapësim, duke theksuar se kreditori procedurën përmbartimor e ka inicuar në bazë të faturës e cila i plotëson kushtet ligjore sipas LPP-së, e njejta është origjinale e nënshkruar, të gjitha elementet që duhet të ketë një faturë dhe asnjë vërejtje nuk kemi patur nga ana e debitorit. Vetë debitori e ka pranuar se ka borxh ndaj nesh, mirëpo i njejti prapësimin e bënë sa të shtyetej prapësimin. Nuk është kontestues fakti se debitori ka realizuar dasmën por i njejti ka pagaur vetëm një pjesë ndërsa ka mbetur obligim ta pagauj edhe 5000.00€, ku shihet se nënshkrimi është i njejtë si në faturë e si në pranimin e fletë kthesës. Andaj edhe pretendimet e debitorit në prapësim janë të pa qëndrueshme dhe të pa baza, pasi që nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhërit. Andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi dhe të mbetet në fuqi Urdhëri Përmbartimor P.nr. 346/21, i datës 07.10.2021.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, e refuzon prapësimin e debitorit si të pa bazuar, për shkak se i njejti nuk përmbush asnjë nga kushtet e parapara të nenit 71 të LPP-së, kjo për shkak se fatura numër 01/07/078/2021, e datës 07.08.2021, është dokument i besueshëm – titull përmbartimor, në bazë të të cilit është lejuar Urdhëri Përmbartimor, konform nenit 29 par 1 nën para 1.3, si dhe par. 3 i LPP-së, në të cilën shprehimisht parashihet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim, poqese në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e në rastin konkret fatura i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që në të janë treguar kreditori, debitori, objekti, shuma e përmbushjes.

Gjithashtu fatura numër 01/07/078/2021, e datës 07.08.2021 është pranuar nga ana e debitorit përmes postës dhe atë me datën 20.09.2021, këtë e vërteton fletkthesa e postës e datës 22.09.2021, ku është cekur se lloji i dërgesës është fatura e dt. 01/07/078/2021 e datës 07.08.2021, e cila është nënshruar nga marrësi Sh. O, andaj edhe gjykata vendosi si në pikën 1, të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 5,29,71,72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
CPK.nr.21/2024 datë 17.04.2024

Gjyqtari
G.A

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij vendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan .